



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGJE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS:**  
**Frëngjishtja për qëllime specifike**

**Ngarkesa:** 6 ECTS, 30 leksione/ 30 seminare  
**Viti akademik/semestri kur zhvillohet:** Viti II, Semestri I  
**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme  
**Programi i studimit:** Master viti i II  
**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

Në leksionet e para do të bëhet një vështrim historik i zhvillimit të metodologjisë së mësimin të Frëngjishtes për qëllime specifike. Do të prezantohen raste të ndryshme të kërkesave për mësimin të frëngjishtes për qëllime specifike si edhe mjetet e analizës për identifikimin e nevojave të mësimnxënies. Do të vijohet me shtjellimin e koncepteve teorike të ndërtimit të një programi në mësimdhënien e një gjuhe të huaj për qëllime specifike si edhe me zbatimin e tyre me raste studimore konkrete. Në leksionet në vazhdim do të trajtojmë kriteret për të ndërtuar dhe analizuar korpuset gjuhësore në fusha të ndryshme specialiteti, parimet metodologjike që duhen patur për të didaktizuar materiale autentike të fushave të ndryshme, mënyrën e konceptimit të veprimtarive gjuhësore dhe kulturore në programin e frëngjishtes për qëllime specifike dhe tipologjinë e tyre. Në përfundim do të prezantohen shembuj konkretë të programeve për mësimin e gjuhës frëngje në fusha të caktuara duke respektuar etapat e inxhinierisë së formimit.

**Objektivat e përgjithshme lëndore:** Kjo lëndë synon të formojë studentët, mësues të ardhshëm të gjuhës frëngje se si të konceptojnë programe formimi në gjuhë të huaj për qëllime specifike për një publik që ka nevoja të caktuara dhe imediate të mësimnxënies në gjuhë të huaj.

- lëndë synon që studenti të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme të informacionit dhe literaturën e shfrytëzuar

**Objektivat specifike lëndore:**

Në këtë lëndë studentët përtej njohurive akademike të tyre në mësimdhënien e

-frëngjishtes si gjuhë të huaj do të njihen me

-metodologjinë e inxhinierisë së formimit,

-tipologjinë e ligjërimeve, analizën ligjërimore dhe të terminologjisë në fusha specifike.